


Të shtëna me armë zjarri tek “Mati 1”, Policia jep detaje



19/12/2024 13:48



Sot rreth orës 12:00, në lagjen “Mati 1” në Prishtinë pati gjuajtje me armë zjarri.

Rastin e ka konfirmuar zëdhënësja e policisë për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

Sipas Ahmetit është arrestuar një person me inicialet I.S., i cili dyshohet se ka shtënë gjatë një ahengu familjar.

“Menjëherë në vendin e ngjarjes kanë dalë zyrtarët policorë të cilët kanë sekuestruar një armë dhe kanë arrestuar personin e dyshuar: I, S, mashkull, i cili kishte shtënë në një aheng familjar. Ndaj tij kanë filluar procedurat e nevojshme policore”, tha Ahmeti.

“Nisur nga fakti se akoma është prezent si dukuri, përdorimi i armëve të zjarrit në ahengje të ndryshme, strukturat operative rajonale të policisë po vazhdojnë punën për parandalimin e kësaj dukurie. Andaj mbështetur mbi këtë bazë, apelojmë të gjithë qytetarët që tu shmangen veprimeve të tilla për arsye të sigurisë së tyre, sigurisë së të tjerëve dhe ceremonitë festive t’i kalojnë pa ndonjë incident”, apelon Policia e Kosovë.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



December 19, 2024

Rreth 400 mijë euro dëmi i shkaktuar nga sulmi terrorist në Ibër-Lepenc



December 19, 2024

Zemaj: Vetëvendosja mund t’i shfrytëzojë paratë e pista për sondazhe



December 19, 2024

Shqetësuese: AKB thotë se mbi 1 mijë e 500 biznese u...



December 19, 2024

“Mjaft është mjaft”: 22 organizata shqiptaro-amerikane letër ShBA-së, Kurtit e Osmanit...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information